LIBRI “SHPIRT”/ “SOUL”
NJË HIMN PËR BUKURINË, NDJENJËN DHE SHPIRTIN NJERËZOR



Para disa kohësh, miku im Shkëlqim (Cim) Harizi, muzikant i njohur dhe për dekada me radhë violinist-spalë i Orkestrës së Teatrit të Operës dhe Baletit, më dhuroi një libër të rrallë me poezi të shkrimtarit shqiptaro-armen Emil Asdurian dhe të ilustruar me imazhe mbresëlënëse me frymë erotike nga piktori i njohur shqiptar Bujar Arizi.

Autori i poezive, Emil Asdurian, është një shkrimtar dhe eseist që jeton në Nju Jork që nga viti 1995. Ai ka botuar tre antologji poetike, një numër esesh dhe romanin *Këmbanat e Heshtjes* (*The Bells of Silence*), të botuar në vitin 2019.

Bujar Arizi, nga ana tjetër, është një artist me famë ndërkombëtare, i përzgjedhur

për t’u përfshirë në botimin prestigjioz që prezanton 100 artistët më të mirë të Evropës, një vlerësim që dëshmon nivelin e lartë artistik dhe njohjen e gjerë që ka fituar krijimtaria e tij në arenën ndërkombëtare.

Dy fjalë për librin

Ky botim përbën një ndërthurje të bukur të poezisë me artin pamor, ku vargu i Emil Asdurianit dhe piktura e Bujar Arizit plotësojnë njëra-tjetrën, duke i dhënë lexuesit një përjetim estetik të veçantë. Libri është botuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke e bërë të qasshëm si për lexuesin shqiptar, ashtu edhe për publikun ndërkombëtar. Poezitë shoqërohen me ilustrime artistike të realizuara me

mjeshtëri të veçantë nga Bujar Arizi. Këto imazhe, të mbushura me sensualitet, elegancë dhe finesë estetike, nuk shërbejnë thjesht si zbukurim i tekstit, por si një dialog i heshtur me poezinë, duke i dhënë asaj dimensione të reja emocionale dhe vizuale.

Në faqet e këtij libri, fjala poetike dhe piktura bashkëjetojnë në harmoni të plotë. Poezia e Emil Asdurianit prek tema universale si dashuria, vetmia, kujtesa, dëshira, kalimi i kohës dhe kërkimi i përhershëm i njeriut për bukurinë dhe kuptimin e jetës. Ndërkohë, ilustrimet e Bujar Arizit u japin këtyre motiveve një shprehje të fuqishme figurative, duke

krijuar një atmosferë që mbetet gjatë në kujtesën e lexuesit.

Ky është një botim që lexohet me kënaqësi, por edhe soditet si një album arti, ku poezia dhe piktura bashkohen për të krijuar një vepër të vetme, të pasur në ndjesi dhe bukuri estetike.

Filozofia artistike e mjeshtrit të madh Albrecht Dürer, e vendosur në hyrje të librit, i hap udhën lexuesit të zhytet në një univers meditimesh që sfidojnë njëkohësisht vetëdijen dhe nënvetëdijen. Ajo shërben si një portë hyrëse drejt botës së ndjenjave, mendimeve dhe përfytyrimeve që shpalosen në faqet e këtij botimi.

Leximi i këtij libri në të dy gjuhët krijon një përjetim të rrallë estetik. Ai ngjall optimizëm, kënaqësi shpirtërore dhe një ndjesi të rafinuar hedoniste, duke e ngritur lexuesin në një hapësirë ku bashkohen bukuria e fjalës, thellësia e mendimit dhe magjia e imazhit. Në këtë kuptim, libri përfaqëson një nga format më të arrira të ndërthurjes së artit poetik, ndjesor, intelektual dhe pamor.

Urime të përzemërta autorëve për këtë vepër të veçantë!

Mal Berisha

“SPIRIT” / “SOUL”

A HYMN TO BEAUTY, EMOTION, AND THE HUMAN SPIRIT



Some time ago, my friend **Shkëlqim (Cim) Harizi**, a distinguished musician and for decades the concertmaster violinist of Albania's Opera and Ballet Theatre Orchestra, presented me with a remarkable volume of poetry by the Albanian-Armenian writer **Emil Asdurian**, beautifully illustrated with evocative and sensual artwork by the renowned Albanian painter **Bujar Arizi**.

The author of the poems, **Emil Asdurian**, is a writer and essayist who has lived in New York since 1995. He has published three poetry anthologies, a number of essays, and the novel *The Bells of Silence*, released in 2019.

Bujar Arizi, on the other hand, is an internationally acclaimed artist whose work has earned him inclusion in a prestigious publication featuring the **100 Best Artists of Europe**, a distinction that reflects both the high artistic quality of his work and the broad recognition he has achieved on the international stage.

A Few Words About the Book

This volume represents a beautiful fusion of poetry and visual art, where the verses of Emil Asdurian and the paintings of Bujar Arizi complement one another, offering the reader a unique aesthetic experience.

Published in both **Albanian and English**, the book is accessible not only to Albanian readers but also to an international

audience. The poems are accompanied by artistic illustrations executed with exceptional mastery by Bujar Arizi. Rich in sensuality, elegance, and aesthetic refinement, these images serve not merely as decorations to the text but as a silent dialogue with the poetry itself, adding new emotional and visual dimensions to the reader's experience.

Throughout its pages, poetic language and visual imagery coexist in complete harmony. Emil Asdurian's poetry explores universal themes such as love, solitude, memory, desire, the passage of time, and humanity's enduring search for beauty and meaning in life. Meanwhile, Bujar Arizi's illustrations provide these themes

with powerful visual expression, creating an atmosphere that lingers in the reader's memory long after the final page has been turned.

This is a book that invites not only reading but contemplation. It may be enjoyed as both a literary work and an art album, where poetry and painting unite to create a single artistic entity rich in feeling, beauty, and inspiration.

The artistic philosophy of the great master **Albrecht Dürer**, presented at the opening of the book, guides the reader into a universe of reflections that challenge both consciousness and the subconscious mind. It serves as a gateway into the world of emotions, thoughts, and imaginings

that unfold throughout this remarkable publication.

Reading this book in both languages creates a rare aesthetic experience. It inspires optimism, spiritual delight, and a refined sense of pleasure, elevating the reader into a realm where the beauty of language, the depth of thought, and the magic of imagery converge. In this respect, the book represents one of the finest examples of the harmonious integration of poetic, emotional, intellectual, and visual art.

My heartfelt congratulations to the authors for this exceptional work.

Mal Berisha
Historian, Writer, Former Diplomat